

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 139/13

Më: 4 korrik 2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Annemarie Meister, kryetare dhe gjyqtare raportuese dhe anëtarët e kolegjit Vahid Halili e Tonka Berisha, gjyqtarë kosovarë të Gjykatës së Apelit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Beti Hohler, si procesmbajtëse,

Në procedurën penale kundër të pandehurve:

- 1. R. B., ...**, i lindur më ... në ..., me vendbanim në fshatin ..., komuna ..., shqiptar me nënshtetësi kosovare, punëtor krahu, i pamartuar, ka të kryer shkollimin e mesëm, me gjendje të keqe ekonomike, i mbajtur në paraburgim nga data 18.03.2012 deri më 17.09.2012 ndërsa në arrest shtëpiak nga 17.09.2012 deri më 17.01.2013,
- 2. F. T., ...**, i lindur më ... në ..., me banim në ..., shqiptar me nënshtetësi kosovare, berber, i pamartuar, ka të kryer shkollimin fillor me gjendje të keqe ekonomike, i mbajtur në paraburgim nga data 18.03.2012 deri më 17.09.2012 ndërsa në arrest shtëpiak nga 17.09.2012 deri më 17.01.2013;

Të akuzuar në bazë të aktakuzës së prokurorit publike PP. 117/2011 të datës 16.07.2012 të ndryshuar më 21.01.2013 për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotrope dhe analoge sipas nenit 23 dhe 229 (4) (1) të Kodit Penal të Kosovës (KPK) ose sipas nenit 31 dhe 273 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK);

I dënuar në shkallë të parë përmes aktgjykimit nr. P 42/2012 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, të shpallur më 29.01.2013 (aktgjykimi me shkrim i datës 25.03.2013) për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotrope dhe analoge, e kryer në bashkëkryerje nga një grup, sipas nenit 31, 273(2) dhe 281(1.1) të KPRK-së dhe nenit 3(2) të KPRK-së;

Duke vendosur mbi ankesat në vazhdim të parashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës nr. P 42/2012 të datës 25.03.2013:

- Ankesa e avokatit mbrojtës Vehbi Beqiri në emër të të akuzuarit R. B., e parashtruar më 15.04.2013,
- Ankesa e avokatit mbrojtës Kadri Osaj në emër të të akuzuarit F. T., e parashtruar më 10.04.2013;

Pas shqyrtimit të mendimit të prokurorit të apelit të shtetit nr. 81/2013 të parashtruar më 13.05.2013;

Pas mbajtjes së seancës publike më 04.07.2013 në praninë e avokatit mbrojtës Vehbi Beqiri dhe të prokurorit të shtetit të EULEX-it Claudio Pala;

Pas këshillimit dhe votimit më 04.07.2013;

Sipas neneve 389, 390, 394, 398, 401, 404 (1) të Kodit të Procedurës Penale, ligjit nr. 04/L-123 (KPP);

Sjell këtë:

A K T G J Y K I M

Ankesa e avokatit mbrojtës Vehbi Beqiri në emër të të akuzuarit R. B., e parashtruar më 15.04.2013 dhe ankesa e avokatit mbrojtës Kadri Osaj në emër të të akuzuarit F.T., e parashtruar më 10.04.2013, të dyja kundër *aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës nr. P 42/2012 të datës 25.03.2013* refuzohen si të pabaza.

Aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Themelore të Mitrovicës nr. P 42/2012, i datës 25.03.2013 vërtetohet.

ARSYETIM

I. Procedura e gjertanishme e lëndës

1. Aktakuza nr. PP 117/2011 kundër të të akuzuarve **R. B., F. T., A. C., F. A.** dhe **L. K.** është ngritur më 16.07.2012 pranë ish – Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës për veprën penale *blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotrope* sipas nenit 229 (4) (1) të Kodit Penal të Kosovës (KPK) ¹ lidhur me nenin 229 (2) të KPK-së. Më 26 korrik 2012, gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës ka nxjerrë aktvendimin për konfirmimin e aktakuzës, duke e konfirmuar në tërësi aktakuzën në fjalë. Gjyqtari konfirmues po ashtu ka pranuar edhe propozimin e avokatit mbrojtës Vehbi Beqiri dhe ka shpallur procesverbalin e bastisjes së shtëpisë së **R. B.** të kryer më datën 18 mars 2012 si provë e papranueshme.

2. Kjo aktakuzë është ndryshuar gojarisht gjatë shqyrtimit gjyqësor më 21 mars 2013 duke ia shtuar referencën e nenit 23 të KPK-së (bashkëkryerjen) në cilësimin juridik të veprës.

¹ Kodi Penal në fuqi nga data 06.04.2004 deri më 31.12.2012.

Përshkrimi faktik në aktakuzë ka mbetur i pandryshuar. Trupi gjykues ka miratuar ndryshimin e aktakuzës.²

3. Shqyrtimi gjyqësor ndaj gjashtë të akuzuarve ka filluar më 21 janar 2013 me seancat gjyqësore të mbajtura më datat 22.01.2013, 23.01.2013, 24.01.2013 dhe më 28.01.2013. Aktgjykimi është shpallur më 29 janar 2013 (në vazhdim: aktgjykimi i kundërshtuar).

4. Trupi gjykues ka shpallur të akuzuarit **R. B.** dhe **F. T.** fajtorë për veprën penale *blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotrope dhe analoge* e kryer në bashkëkryerje nga grupi sipas neneve 3 (2), 31, 273 (2) dhe 281 (1.1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04 – L – 082 (në vazhdim: KPRK).³ Trupi gjykues ka dënuar **R. B.** me gjobë prej 30 eurosh dhe me burgim prej një viti e gjashtë muajsh. Trupi gjykues ka dënuar **F. T.** me gjobë prej 20 eurosh dhe me burgim prej një viti. Trupi gjykues ka liruar të akuzuarit **A. C.** dhe **F. A.** për të njëjtën vepër penale sipas nenit 3 (2) të KPRK-së dhe nenit 364 (1.3) të KPP-së. Trupi gjykues ka refuzuar akuzën kundër **L. K.** sipas nenit 3 (2) të KPRK-së dhe nenit 363 (1.1) të KPP-së. Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar në mars të vitit 2013 dhe mban datën 25 mars 2013. Kur i referohet aktgjykimit të kundërshtuar, Gjykata e Apelit do t'i referohet datës së aktgjykimit të arsyetuar.

5. Gjykata e Apelit ka para vetes dy ankesat e parashtruar nga avokati mbrojtës i të akuzuarit **R. B.**, përkatësisht **F. T.**, të cilat janë ushtruar kundër aktgjykimit të kundërshtuar.

6. Gjykata e Apelit ka mbajtur një seancë publike lidhur me lëndën më 4 korrik 2013 në praninë e avokatëve mbrojtës Vehbi Beqiri dhe prokurorit të apelit të EULEX-it Claudio Pala. Të akuzuarit **R.B.** dhe **F.T.** dhe mbrojtësi Kadri Osaj nuk kanë marrë pjesë në seancë. Kolegji ka konfirmuar se dy të pandehurit dhe mbrojtësi kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt në seancë dhe seanca është mbajtur në përputhje me nenin 390 (4) të KPP-së.

II. Parashtrësit e palëve

Ankesat

*(Ankesa në emër të **R. B.**)*

7. Avokati mbrojtës Vehbi Beqiri nuk deklaron në mënyrë specifike në ankesën e cila është parashtruar në emrin e tij, ai vetëm përdor termin i pandehur dhe deklaron se i pandehuri është dënuar me një vit e gjashtë muaj burgim dhe është urdhëruar të paguajë gjobën në vlerë prej 30 eurosh. Ai vetëm kundërshton dënimin e caktuar dhe propozon që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar duke sjellë një dënim më të butë ose një masë alternative. Avokati

² Shih procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, P 42/2012, seanca e mbajtur më 21.01.2013, faqe 7 (versioni në anglisht)

³ Kodi Penal i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

mbrojtës pretendon se Gjykata Themelore nuk ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese në vazhdim kur ka caktuar dënimin:

- Keqardhjen dhe pranimin e fajit nga i akuzuari,
- Kushtet në të cilat është kryer vepra penale, në veçanti mënyra e sigurimit të narkotikëve nga ana e të pandehurit,
- Fakti se i pandehuri ka lozur një rol relativisht të vogël në kryerjen e veprës,
- Fakti se i pandehuri është i moshës së re dhe jeton në rrethana të rënda ekonomike dhe sociale dhe se është i vetmi mbajtës i familjes,
- Fakti se i pandehuri ka bashkëpunuar me autoritetet gjatë hetimeve dhe me gjykatën,
- Fakti se sjellja e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale ka qenë e shkëlqyeshme,
- Fakti se i pandehuri nuk është dënuar më parë dhe ndaj tij nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë tjetër penale.

(Ankesa në emër të F. T.)

8. Avokati mbrojtës Kadri Osaj e kundërshton sanksionin e shqiptuar penal. Ai propozon anulimin e aktgjykimit të kundërshtuar dhe kthimin e lëndës në rivendosje në gjykatë themelore ose uljen në gjashtë muaj burgim të dënimit të shqiptuar ndaj **F. T.** ose shqiptimin e dënimit me kusht ose me gjobë nga ana e Gjykatës së Apelit. Avokati mbrojtës ngre këto argumente:

- Gjykata Themelore ka shpallur **F. T.** fajtor për veprën penale sipas nenit 273 (2) të KPRK-së, por dënimi iu shqiptuar në bazë të nenit 273 (1) dhe (3) të KPRK-së. Dënimi minimal sipas nenit 273 (2) të KPRK-së është dy vjet dhe me zbatimin e nenit 74 (3) 3.10) dhe të nenit 76 (1.4) të KPRK-së, dënimi mund të ulet deri në burgim prej gjashtë muajsh. Trupi gjykues është dashur ta aplikojë këtë dispozitë dhe jo nenin 76 (1.3) të KPRK-së, duke pasur parasysh se **F. T.** nga momenti i arrestimit ka pranuar fajin, ka shprehur keqardhje dhe ka premtuar se nuk do t'i përsërisë veprat penale.
- Po qe se ulja e dënimit në gjashtë muaj nuk është e mundshme atëherë mbrojtja konsideron se një masë alternative duhet të zëvendësojë pjesën tjetër të dënimit të cilin të akuzuarit ende nuk e kanë mbajtur në bazë të neneve 51 dhe 52 (4) të KPRK-së.

Përgjigjja e prokurorisë në këto ankesa

9. Prokuroria themelore e EULEX-it në Mitrovicë ka parashtruar përgjigjen në këto dy ankesa më datën 29 prill 2013. Prokurori në këtë lëndë deklaroi se këto ankesa duhet të hedhen poshtë ose si alternativë tjetër të refuzohen si të pabaza.

10. Prokurori parashtron se ankesa e avokatit mbrojtës Vehbi Beqiri nuk përmban informatat në vazhdim të cilat përcaktohen me KPP: emri i të pandehurit (neni 361 (1.1.) i KPP-së); përshkrimi i bazës ligjore të kërkesës (neni 376 (1.5) i KPP-së), përshkrimi i bazës ligjore për mjetin juridik (neni 376 (1.7) i KPP-së), deklarata e dëshmitarit se se i njëjti pajtohet me kërkesën e bërë nga

avokati mbrojtës (neni 376 (1.8.) të KPP-së), nënshkrimi i ankuesit (neni 382 (1.4) të KPP-së). Prokurori, duke u mbështetur në nenet 376 dhe 382 të KPP-së, pretendon se ankesa nuk duhet të shqyrtohet. Si alternativë, prokurori parashtron se trupi gjykues në mënyrë të duhur ka shqyrtuar rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, duke përfshirë faktin se **R. B.** ka luajtur rolin udhëheqës në grupin kriminal.

11. Prokurori parashtron se ankesës së ushtruar nga avokati mbrojtës Kadri Osaj i mungojnë këto informata: përshkrimi i bazës ligjore për mjetin juridik (neni 376 (1.7) i KPP-së), deklarata e dëshmitarit se se i njëjti pajtohet me kërkesën e bërë nga avokati mbrojtës (neni 376 (1.8.) të KPP-së), nënshkrimi i ankuesit (neni 382 (1.4) të KPP-së). Prokurori, duke u mbështetur në nenet 376 dhe 382 të KPP-së, pretendon se ankesa nuk duhet të shqyrtohet. Prokurori po ashtu e kundërshton ankesën lidhur me meritat. Ai parashtron se referimi i nenit 273 (3) të KPRK-së nën titullin ‘dënimi’ është një gabim shtypi. Është e qartë se ky gabim shtypi nuk ka pasur ndikim në vendimin mbi dënimin të Gjykatës Themelore. Më tej, avokati mbrojtës nuk ka bërë të ditur se i akuzuari **F.T.** është shpallur fajtor për kryerje të veprës penale si anëtar i grupit në përputhje me nenin 281(1.1.) të KPRK-së, për të cilën dënimi minimal me burgim është tre (3) vjet.

Propozimi i prokurorit të apelit të shtetit

12. Prokurori i apelit i shtetit mbështet përgjigjen e dhënë nga prokurori i lëndës.

13. Sa i përket ankesës së parashtruar nga avokati mbrojtës i **F. T.**, prokurori i apelit i shtetit parashtron se ankesës i mungon një deklaratë se e njëjta është parashtruar me pëlqimin e të akuzuarit. Kjo bëhet e qartë me përdorimin e shprehjes “ex officio” në ankesë. Prokurori i apelit i shtetit konsideron se ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejuar sipas nenit 400 të KPP-së, lidhur me nenin 376(4) të KPP-së.

14. Sa u përket meritave, prokurori i apelit i shtetit parashtron se duke u bazuar në akuzë dhe në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar, referimi i nenit 273 (3) të KPRK-së është gabim shtypi dhe i njëjti e thekson faktin se dispozitivi dhe arsyetimi duhet domosdo të lexohen së bashku si një tërësi.

15. Lidhur me ankesën e parashtruar nga avokati mbrojtës i **R. B.**, prokurori i apelit i shtetit parashtron se ankesës i mungon emri i të pandehurit dhe deklarata e tij se ka dhënë pëlqimin e tij për kërkesën e bërë nga avokati mbrojtës. Ai propozon që Gjykata e Apelit ta hedhë poshtë ankesën si të palejuar. Lidhur me meritat, prokurori i apelit i shtetit parashtron se të gjitha rrethanat të cilave iu referohet ankesa, përveç pretendimit mbi moshën e re, janë marrë parasysh nga ana e trupit gjykues dhe janë vlerësuar ashtu si duhet. Ai konsideron se ankesa në fjalë është e pabazë.

III. Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Kompetenca e Gjykatës së Apelit

16. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur mbi ankesat në bazë të neneve 17 dhe 18 të Ligjit mbi Gjykatat (Ligji nr. 03 / L – 199).

17. Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhje me nenin 19 (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe me nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03 / L - 053). Në bazë të vendimit të kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it nr. 2013 – OPEJ – 0289 – 001 të datës 03.07.2013, të marrë në përputhje me nenin 3.7 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë, kolegji ka qenë i përbërë nga një gjyqtar i EULEX-it dhe dy gjyqtarë kosovarë të Gjykatës së Apelit.

Pranueshmëria e ankesave

(pranueshmëria e ankesës së ushtruar nga avokati mbrojtës Vehbi Beqiri)

18. Ankesa është e pranueshme.

19. Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës Vehbi Beqiri nuk e përmend në mënyrë eksplicite emrin e të akuzuarit për të cilin është parashtruar. Megjithëkëtë, duke pasur parasysh përmbajtjen e ankesës në fjalë dhe të informatave të ofruara në të (dënimi i shqiptuar, rrethanat personale), dhe faktin se Vehbi Beqiri gjatë tërë procedurës ka vepruar si avokat mbrojtës i të akuzuarit **R. B.**, është e qartë se kjo ankesë është parashtruar në emër të të akuzuarit **R.B.**

20. Ankesa në fjalë përmban të gjitha informatat të cilat në mënyrë specifike janë të përmendura në nenin 382 (1) 1.1.) deri në 1.4.) të KPP-së,⁴ duke përfshirë këtu edhe nënshkrimin e avokatit mbrojtës.⁵ Konstatimi i prokurorit se mungon nënshkrimi i ankuesit prandaj faktikisht është i pasaktë.

21. Ankesa nuk përmban një deklaram se është ushtruar me pajtimin e të akuzuarit, megjithatë mungesa e një deklarimi të tillë sipas këndvështrimit të Gjykatës së Apelit nuk e justifikon hedhjen poshtë të ankesës. Gjykata konsideron se hedhja poshtë për këtë arsye do të justifikohet vetëm nëse do të kishte të dhëna bindëse se ankesa është ushtruar kundër vullnetit të të akuzuarit. Asgjë në ankesën përkatëse apo shkresat e lëndës nuk sugjeron se i akuzuari **R.B.** nuk e ka mbështetur ushtrimin e ankesës në emër të tij.

22. Gjykata e Apelit vëren se edhe po ta kishte konsideruar se ankesa nuk përmban informata të nevojshme, ajo përsëri nuk do të kishte të drejtën të hedh poshtë atë pa kërkuar së pari plotësimin sipas nenit 442(4) të KPP-së.

⁴ Indikacioni i aktgjykimit kundër të cilit është ushtruar ankesa, arsyet për kundërshtimin e aktgjykimit në bazë të nenit 383 të KPP-së, propozimi për kthimin prapa të aktgjykimit të kontestuar qoftë në tërësi apo pjesërisht, apo për ta ndryshuar të njëjtin si dhe nënshkrimi i ankuesit, 35.

⁵ Shih parashtruesën origjinale në gjuhën shqipe, të nënshkruar dhe të vulosur në mënyrë të rregullt në fund të dokumentit, në faqen 2 të ankesës.

23. Gjykata e Apelit më tej vë në pah se dispozitat e kodit duhet të lexohen medoemos si tërësi dhe konsideratë e veçantë duhet t'u kushtohet dispozitave që kanë të bëjnë me ankesat kundër aktgjykimeve. Ndonëse neni 376 (4) i KPP-së si rregulle të përgjithshme të kapitullit të tij lidhur me të gjitha kërkesat për mjete juridike përcakton se asnjë kundërshtim ose kërkesë që nuk është në pajtim me këtë nen nuk shqyrtohet, kodi megjithatë përfshin edhe dispozita të caktuara në nënkapitujt përkatës për atë se kur gjykata mund të hedh poshtë mjetet juridike.

24. Lidhur me ankesat kundër aktgjykimeve, kodi në mënyrë specifike rendit rrethanat kur një ankesë kundër aktgjykimit mund të hedhet poshtë. Këto dispozita duhet të shqyrtohen *lex specialis* në krahasim me klauzolën e përgjithshme të përfshirë në nenin 376(4) të KPP-së. Neni 399 dhe neni 400 të KPP-së parashohin që ankesa kundër aktgjykimit mund të hedhet poshtë vetëm nëse është e paafatshme ose “kur vërtetohet se është paraqitur nga personi i cili nuk ka të drejtë ankese ose nga personi i cili ka hequr dorë nga ankesa, apo kur vërtetohet se ankesa është tërhequr, apo kur vërtetohet se ankesa e tërhequr është paraqitur sërish apo ankesa nuk është e lejuar me ligj”.

25. Dispozitat e tjera të nënkapitullit, vënë në pah po ashtu se hedhja poshtë e ankesës kundër aktgjykimit lejohet vetëm në rrethana të kufizuara. Për shembull, sipas nenit 382(2) të KPP-së, gjykata nuk lejohet të hedh poshtë ankesën kundër aktgjykimit të paraqitur nga një i akuzuar i pa përfaqësuar apo palë e dëmtuar, madje edhe nëse ankuesi nuk e respekton udhëzimin për plotësim për aq sa informatat e nevojshme mund të zbulohen lehtë. Më tej kur një ankesë kundër aktgjykimit nuk përmban asgjë tjetër përveç një indikacioni të aktgjykimit dhe nënshkrimin e ankuesit, sipas nenit 394(2) të KPP-së gjykata është përsëri e obliguar të bëjë një shqyrtim *ex officio* në pajtueshmëri me nenin 394(1) të KPP-së dhe të shqyrtoj vendimin mbi dënimin, trajtimin e detyrueshëm për rehabilitim dhe dobinë pasurore.

26. Leximi sistematik i kodit nxjerr në shesh se hedhja poshtë e ankesave kundër aktgjykimit është e paraparë vetëm përjashtimisht dhe kodi favorizon adresimin e ankesës mbi meritat sa më shumë që të jetë e mundur.

27. Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës Vehbi Beqiri përfshin informata relevante që duhet adresohen dhe është ushtruar nga personi i autorizuar. Ankesa është e pranueshme dhe do të adresohet mbi meritat.

(Pranueshmëria e ankesës së ushtruar nga avokati mbrojtës Kadri Osaj)

28. Ankesa është e pranueshme.

29. Ankesa e avokatit mbrojtës Kadri Osaj është ushtruar në emër të të akuzuarit **F.T.**

30. Ankesa përmban të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë specifike ato të renditura në nenin 382 (1) 1.1.) deri 1.4.) të KPP-së, përfshirë nënshkrimin e avokatit mbrojtës.⁶

31. Ankesa nuk përmban një deklaram se është ushtruar me pajtimin e të akuzuarit, megjithatë mungesa e një deklarimi të tillë sipas këndvështrimit të Gjykatë së Apelit nuk e justifikon hedhjen poshtë të ankesës, sikurse është shtjelluar tanimë më sipër lidhur me ankesën e avokatit mbrojtës Beqiri. Gjykata konsideron se hedhja poshtë për këtë arsye do të justifikohet vetëm nëse do të kishte të dhëna bindëse se ankesa është ushtruar kundër vullnetit të të akuzuarit. Asgjë në ankesën përkatëse apo shkresat e lëndës nuk sugjeron se i akuzuari **F.T.** nuk ka mbështetur ushtrimin e ankesës në emër të tij.

32. Në pjesën ku prokuroria shtyn për hedhjen poshtë edhe të kësaj ankese për shkak të mungesës së informatave sipas nenit 376 (1) të KPP-së, gjykata i referohet arsyetimit të saj të më sipërm në paragrafët 22-26. I njëjti arsyetim vlen edhe për këtë ankesë.

33. Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës Kadri Osaj përfshin informata relevante që duhet adresuar dhe është ushtruar nga personi i autorizuar. Ankesa është e pranueshme dhe do të adresohet mbi meritat.

Gjetjet mbi meritat

Ligji penal në fuqi

34. Sipas nenit 3 të KPRK, ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Megjithatë, në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.

35. Përcaktimi mbi ligjin më të favorshëm nuk duhet të bazohet në një krahasim abstrakt apo kundërshtues të ligjeve në fjalë, p.sh. duke përcaktuar se cili ligj është më i butë në terme abstrakte dhe të përgjithshme. Përkundrazi, gjykata doemos do të shikoj dispozitat në fuqi në lëndën e caktuar ndaj kryerësit të caktuar. Duke krahasuar në mënyrë të kujdesshme dispozitat të cilat do të zbatohen në lëndën konkrete, gjykata mund të përcaktoj se cili ligj është më i favorshëm për të akuzuarin e caktuar. Me fjalë të tjera, ligji i cili objektivisht konsiderohet më pak i butë mund të vlerësohet më i butë lidhur me një kryerës të caktuar dhe një krim të caktuar. Me qëllim të përcaktimit se cili ligj është më i favorshëm për kryerësin, gjykata gjithsesi duhet të marrë parasysh elementet dhe dallimet e ndryshme në mes ligjeve të cilat ndërlidhen me kryerësin në fjalë.⁷

⁶ Shih parashtrësata origjinale në gjuhën shqipe, të nënshkruara dhe vulosura sipas rregullit në fund të dokumentit, f. 2 e ankesës.

⁷Shih për një përmbledhje

në:http://wcjp.unicri.it/deliverables/docs/Module_5_Domestic_Application_of_International_Law.pdf (last accessed 3.09.2013)

36. Të akuzuarit **F.T.** dhe **R. B.** u akuzuan për veprën penale të Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike sipas Kodit penal të Kosovës që ishte ligj në fuqi në vitin 2012 kur është kryer vepra penale. Kodi i ri penal i Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi më 01.01.2013. Në aktgjykimin e tij të datës 25.03.2013 trupi gjykues ndaj të pandehurve zbatoi Kodin e ri penal (në fuqi nga 01.01.2013), duke nxjerr konkluzionin se ky i fundit është më i favorshëm për të akuzuarin.

37. Arsyetimi i trupi gjykues mbi ligjin e zbatueshëm është i pamjaftueshëm dhe sipas këndvështrimit të Gjykatës së Apelit nuk e mbështet konkluzionin e nxjerr. Megjithatë Gjykata e Apelit, pavarësisht arsyeve të ndryshme, nxjerr edhe konkluzionin se Kodi penal i ri i Republikës së Kosovës është ligj më i favorshëm për tu zbatuar ndaj të akuzuarve **R.B.** dhe **F.T.**.

38. Krahasimi i dy ligjeve nga ana e trupit gjykues është i kufizuar me analizën e termit “ndërmjetëson” në nenin 273(2) të KPRK.⁸ Në krahasim me nenin 229(2) të KPK-së, neni 273(2) të KPRK përfshin konkretisht tri veprime shtesë të cilat janë të dënueshme me dispozitën e re: ‘ndërmjetëson’, ‘dërgon’, ose ‘dërgon në transit’. Ndërsa me kodin e vjetër, ky lloj i veprimit mund të ndiqej penalisht si formë e ndihmës, sipas kodit të ri i njëjti dënohet veçan dhe përbën kryerje të veprës penale përkatëse. Andaj shtrirja e nenit 273(2) të KPRK është më e gjerë sesa shtrirja e nenit 229(2) të KPK-së dhe si i tillë ky nen *nuk* është më i butë për të pandehurin. Thënë ndryshe, përderisa një i pandehur që ndërmjetëson shitjen do të mund të akuzohet vetëm për ndihmë në veprën penale, sipas kodit të ri ai do të akuzohet me kryerje të veprës penale. Në këtë aspekt, arsyetimi i trupit gjykues prandaj është me të meta.

39. Gjykata e Apelit megjithatë vë në dukje se përfshirja e ndërmjetësimit si formë e kryerjes nuk është thelbësore për përcaktimin e ligjit më të favorshëm në lëndën në fjalë. Sipas gjetjeve faktike të trupit gjykues e të cilat janë të pakontestueshme për ankesën, pikërisht dy të akuzuarit kanë bërë *transportimin* e narkotikëve me ç’ rast transportimi është veprim i dënueshëm edhe me KPRK e edhe me KPK.⁹

40. Gjykata e Apelit vëren dallimin në dënimet e parapara në mes të nenit 273(2) të KPRK dhe nenit 229(2) të KPK-së.¹⁰ Megjithatë, këto janë jo relevante pasi që të pandehurit janë shpallur

⁸ Trupi gjykues ka dhënë këtë arsyetim: “Gjykata konsideron se “ndërmjetëson” sipas nenit 273(2) të KPRK mund të mbulojë situatën kur arrihet një marrëveshje ndërmjet dy aktorëve kryesor, nuk është e domosdoshme që aktiviteti të përfshijë kryerësin vetëm si ndërmjetësues në ndonjë marrëveshje ndërmjet dy aktorëve tjerë kryesor. Në gjuhën angleze folja “ndërmjetëson” do të thotë të rregullosh apo negociosh një marrëveshje ndërsa versioni në gjuhën shqipe i KPRK i referohet kësaj si “ndërmjetëson” që në gjuhën angleze përkthehet si “mediates”. Kjo do të thotë që aktiviteti është më i gjerë sesa vetëm ai që kryhet nga një negociues apo ndërmjetësues dhe mund të përfshijë dy aktorët kryesor në një marrëveshje.” Para. 39 i aktgjykimin të kundërshtuar.

⁹ Gjykata e Apelit vëren se nëse i pandehuri **F.T.** do të ishte gjetur vetëm si ndërmjetës në shitje, në një rast të tillë, së paku sa i përket atij, Kodi penal i Kosovës do të ishte më i butë dhe prandaj ligj i aplikueshëm pasi që KPK-ja nuk e penalizon në mënyrë specifike ndërmjetësimin ashtu sikurse neni 273(2) i KPRK.

¹⁰ Kodi i ri parasheh një afat më të gjatë burgimi për veprën penale përkatëse krahasuar me kodin e mëhershëm. Neni 273(2) i KPRK parasheh një dënim me gjobë dhe burgim në afat prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet, ndërsa neni 229(2) i KPK-së parasheh dënimin me gjobë dhe burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

fajtor për veprë penale si anëtarë të grupit, sipas formës së cilësuar të veprës penale. Kjo është gjetje faktike e pa kontestuar në procedurë. Prandaj krahasimi i dënimit të paraparë gjithsesi duhet të bëhet në bazë të dënimit të paraparë për formën e cilësuar të veprës penale. Me të dy ligjet dënimi është i njëjtë – gjobë dhe dënim prej tri (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet (shih nenin 229(4)1) të KPK-së dhe nenin 281(1.1.) të KPRK.¹¹

41. **R. B.** dhe **F. T.** pranuan fajësinë për veprën penal. Rëndësi e veçantë i është kushtuar një dispozite të re, që më parë nuk është përfshirë në KPK lidhur me të akuzuarit të cilët pranojnë fajësinë apo arrijnë marrëveshje për pranimin e fajësisë. Sipas nenit 75(1.3.) të KPRK, në raste të tilla gjykata nuk është e kufizuar në limitet e zbutjes së dënimit të paraparë me nenin 76 të KPRK. Gjykata mund të jap dënim më të ulët sesa kufijtë e përgjithshëm të paraparë të zbutjes të përcaktuar me ligj. Gjykata e Apelit e konsideron këtë dispozitë vendimtare në përcaktimin e ligjit më të favorshëm në lëndën në fjalë.

42. Pasi që sipas nenit 75(1.3) të KPRK-së dënimi për një të akuzuar i cili pranon fajësinë mund të zbutet nën kufijtë e paraparë me nenin 76 të KPRK-së, KPRK i ri është më i favorshëm për të akuzuarin **R.B.** dhe **F.T.**. Ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale nuk e ka paraparë një mundësi të tillë.

43. Gjykata e Apelit vë në pah se trupi gjykues ka arritur në të njëjtin konkluzion, përkundër arsytimit ndryshe i cili, siç është shtjelluar më lart, nuk mbështetet nga Gjykata e Apelit. Trupi gjykues në asnjë pikë nuk i është referuar nenit 75(1.3.) të KPRK-së të cilin Gjykata e Apelit e konsideron më të rëndësishmin në vlerësim.

44. Për referim në të ardhmen, Gjykata e Apelit rithekson se gjykatat medoemos duhet të bëjnë me kujdes vlerësimin e ligjit në fuqi dhe të japin arsyetim të qartë, në veçanti, kur ato zbatojnë kodin në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale në pajtueshmëri me përjashtimin në nenin 3(2) të KPRK-së. Gjykata e Apelit konstaton se një vlerësim i tillë i qartë mungon në aktgjykimin e kundërshtuar megjithëse konkluzioni përfundimtar i kolegjit është korrekt.

Ankesa në emër të të akuzuarit R. B.

45. Trupi gjykues zvogëloi dënimin e të akuzuarit nën kufijtë e paraparë me ligj. Në aktgjykimin e kundërshtuar referimi në nenin 74(3.10.) të KPRK do të linte të kuptohej se trupi gjykues konsideroi pranimin e fajësisë të ishte një rrethanë në të cilën trupi gjykues bazoi konkluzionin e tij lidhur për zvogëlimin e përmendur. Trupi gjykues megjithatë në aktgjykimin e kundërshtuar nuk i referohet nenit 75(1.3.) të KPRK i cili i mundëson gjykatës të zvogëlojë dënimin nën kufijtë e caktuar me nenin 76 të KPRK. Trupi gjykues në fakt e bëri këtë lidhur me gjobën e

¹¹ Gjykata e Apelit vëren se ndërsa KPK-ja përfshinte formën e cilësuar të veprës penale (kryerësi vepron si anëtar i grupit) me të njëjtin nen si paragraf shtesë, kodi i ri përcaktoi një qasje tjetër sistematike. Në kodin aktual format e cilësuar të veprave penale në kapitull janë përfshirë në një nen të ndarë (neni 281 i KPRK), në vend të paragrafëve shtesë nën secilin nen përkatës. Qasja sistematike ndryshe megjithatë ka ndikim në substancën e dispozitës. Neni 229(4)1) i KPK-së plotësisht korrespondon me nenin 281(1)1.1.) të KPRK.

shqiptuar. Në përcaktimin e dënimit me burgim, trupi gjykues qëndroi brenda kufijve të nenit 76(1.3.) të KPRK dhe shqiptoi dënimin me burgim me një vit e gjashtë muaj.

46. Ankesa përmban se trupi gjykues nuk e konsideroi një numër rrethanash të rëndësishme lehtësuese kur përcaktoi dënimin për të akuzuarin.

47. Trupi gjykues i konsideroi si rrethana lehtësuese rrethanat në vijim: pranimin e fajësisë nga i akuzuari, bashkëpunimin e tij me hetuesin, atë se nuk ka dënime të mëhershme, llojin dhe sasinë e substancave të konfiskuara.

48. I akuzuari nuk ka bashkëpunuar plotësisht me policin dhe prokurorinë. Në mënyrë specifike, i akuzuari pranoi fajësinë për përfshirjen e tij por nuk ka bashkëpunuar me hetimet për identitetin e furnizuesit të drogës, sikurse edhe është vënë në pah nga trupi gjykues. I akuzuari prandaj nuk mund të cilësohet se ka bashkëpunuar plotësisht me hetimet.

49. Gjykata e Apelit pajtohet me vlerësimin e trupit gjykues se i akuzuari **R.B.** ka luajtur një rol udhëheqës në organizimin e blerjes dhe shpërndarjen e substancave të ndaluara. Kjo bazohet në gjendjen faktike të vërtetuar nga trupi gjykues dhe të pranuar nga i akuzuari. Pikëpamja se i akuzuari ka luajtur një rol minor në veprën penale prandaj u refuzua. Gjykata e Apelit njëherazi refuzon argumentin se i akuzuari ishte në moshë të re kur ka kryer veprën penale. I akuzuari ishte 36 vjet në atë kohë, që nuk është moshë e re dhe e ndjeshme e cila mund të trajtohet si rrethanë lehtësuese.

50. Rrethanat ekonomike të pretenduara të të akuzuarit nuk mund të konsiderohen rrethanë lehtësuese. I akuzuari është person i shëndosh me shkollim të mesëm, pra plotësisht në gjendje për ta mbajtur veten duke gjetur punësim të ligjshëm në vend të kërkimit të të ardhurave nga veprat penale.

51. Lidhur me sjelljen e të akuzuarit pas veprës penale, Gjykata e Apelit vëren se trupi gjykues tanimë konsideroi si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga i akuzuari, bashkëpunimin e tij me autoritetet, dhe pranimin e përgjegjësisë së tij penale. Gjykata e Apelit konsideron se faktorët e përmendur lehtësuese janë të gjithë demonstrime të sjelljes së të akuzuarit pas veprës penale, pra kjo e fundit nuk mund të konsiderohet si një rrethanë shtesë lehtësuese.

52. Gjykata e Apelit konsideron se trupi gjykues në mënyrë korrekte vlerësoi rrethanat lehtësuese në lëndë dhe shqiptoi një dënim proporcional në përputhshmëri me ligjin.

53. Në pjesën që ka të bëjë me shqiptimin e afatit të burgimit, Gjykata e Apelit pajtohet me trupin gjykues se burgimi prej një vit e gjashtë muaj është proporcional me peshën e veprës si edhe me sjelljen dhe rrethanat e të akuzuarit. Edhe një herë vihet në dukje se dënimi është zvogëluar në mënyrë substanciale. Sipas këndvështrimit të kolegjit, çdo reduktimi tjetër i dënimit, edhe pse i lejuar me ligj, nuk do të ishte i justifikuar duke pasuar parasysh se i akuzuari

luajti rol të rëndësishëm në grupin kriminal të përfshirë në transportimin dhe shitjen e narkotikëve.

54. Gjykata e Apelit prandaj vërteton vendimin e trupit gjykues lidhur me dënimin e shqiptuar.

Ankesa në emër të të akuzuarit F. T.

55. Gjykata e Apelit refuzon parashtresën se trupi gjykues bazoi vendimin e tij në nenin 273(3) të KPRK në vend të nenit 273(2) të KPRK. Gjykata e Apelit konfirmon se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar të datës 25.03.2013 në pjesën e dënimit përmban referimin në nenin 273(3) të KPRK-së, megjithatë kjo në mënyrë të qartë është gabim në shtypje. Çdo kund tjetër në aktgjykimin e kundërshtuar (p.sh dispozitivi në shpalljen fajtor dhe në arsyetim) trupi gjykues gjithëherë i referohet nenit 273(2) të KPRK-së. Paragrafi (3) i nenit 273 të KPRK-së ka të bëjë me importimin dhe eksportimin e substancave të ndaluara dhe kjo asnjëherë nuk është konsideruar ose referuar nga trupi gjykues prandaj në mënyrë të qartë referimi në atë paragraf në pjesën e dënimit të dispozitivit është gabim në shtypje.

56. Gjykata e Apelit po ashtu qartëson se i akuzuar nuk ka arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë me prokurorinë por ka pranuar fajësinë në procedurë para gjykatës. Referencat në ankesë për ‘marrëveshjen për pranimin’ prandaj janë jo të duhura.

57. Në fund, ankesa nuk e pranon se i akuzuari është shpallur fajtor për formën e cilësuar të veprës penale të kryer në grup. Afati minimal i burgimit i paraparë për këtë veprë penale nuk është dy vjet por tri vjet. Neni 76(1.3.) i KPRK-së lejon që dënimi me burgim të ulet deri në një vit, e jo gjashtë muaj sikurse argumentohet nga avokati mbrojtës. Megjithatë vihet në dukje, ashtu sikurse u shtjellua më lart, se gjykata në këtë lëndë për shkak të nenit 75(1.3.) të KPRK-së nuk kufizohet me limitet e zbutjes të parapara me nenin 76 të KPRK-së.

58. Gjykata e Apelit megjithatë konstaton se çdo zvogëlim tjetër i kohëzgjatjes së burgimit do të ishte jo proporcional dhe nuk do të plotësonte objektivat e dënimit. Gjykata e Apelit vëren se kohëzgjatja minimale e burgimit e paraparë për këtë veprë penale është tri vjet dhe maksimale është pesëmbëdhjetë vjet, pra zvogëlimi në një vit burgim është tashmë i bollshëm. Gjykata e Apelit vëren se vepra penale për të cilën i akuzuari **F.T.** u dënua është e drejtuar kundër shëndetit publik dhe ai ka kryer veprën si anëtar i grupit gjë e cila tregon një veprimtari të organizuar e ndërlidhur me shpërndarjen e narkotikëve.

59. Gjykata e Apelit pajtohet me trupin gjykues lidhur me dënimin e shqiptuar dhe nuk gjen ulje tjetër apo dënim alternativ proporcional me veprën e kryer penale. Vendimi i trupit gjykues lidhur me dënimin e shqiptuar vërtetohet.

Konkluzioni

60. Në përputhshmëri me gjetjet e lartë përmendura, Gjykata e Apelit refuzon si të pabazuara ankesat të cilat kundërshtojnë dënimin e shqiptuar penal.

61. Gjykata e Apelit njëherazi nuk gjen shkelje sipas nenit 394 të KPP-së.

62. Rrjedhimisht Gjykata e Apelit refuzon të dy ankesat dhe vërteton aktgjykimin e kundërshtuar në pajtueshmëri me nenin 401 të KPP-së.

63. Prandaj u vendos si në dispozitiv.

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Aktgjykimi i arsyetuar përfundoi më 03.09.2013.

Kryetarja e kolegjit

Annemarie Meister

gjyqtare e EULEX-it

Anëtarja e kolegjit

Tonka Berisha

gjyqtare

Anëtari i kolegjit

Vahid Halili

gjyqtar

Procesmbajtëse

Beti Hohler

Zyrtare ligjore e EULEX-it

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Pakr 139/13

4 korrik 2013